

PROCESVERBAL 24/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 5 (pestë) për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 24.05.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;

5.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është një iniciativë e këshillit iniciues të ish tre Kryetarëve të Komunës të cilën e ka përkrah edhe Kryetari aktual z.Bali Muharremaj,që Christoph Palm nga Gjermania të shpallet Qytetar Nderi i Komunës së Suharekës për arsye se që nga viti 2000 e këndej ka kontribuar në Komunën tonë lidhur me çështjen e shtëpisë së Felbahut apo qendrës rinore në Suharekë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që thirrja ka qenë e hapur dhe transparente për të gjithë.Propozimet kanë ardhë nga kryesitë e fshatrave dhe disa propozime kanë ardhë nga gjenerali Gëzim Hazrolli,ku komisioni i ka shqyrtu dhe i ka rekomandu Kuvnedit të Komunës që këto propozime ti miratojnë siq i kanë cek në projekt-vendim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;

Avni Bytyqi - plani është i bazuar në strategji i cili është i miratuar nga qeveria e Republikës së Kosovës. Ka të bëjë me personat që riatdhesohen dhe kthehen në Komunën tonë, të cilët për momentin nuk mund ta gjejnë veten deri sa të stabilizohen, andaj Komuna ka për obligim që ti ndihmojë në periudhën gjashtë mujore si fillim. Po ashtu është edhe komisioni i cili merret me shqyrtimin e kësaj çështje.

Xheladin Sadikaj - na është kërku ta procesojmë përmes Asamblesë. Kemi planin e veprimit në nivel qëndror, i njëjti por vetëm me disa kushte dhe përshtatje të strategjisë lokale.

Kryesuesi - zyra e vetme e cila merret me këtë çështje është zyra për çështje të komuniteteve në Komunën tonë. Patjetër që duhet të jetë edhe një zyrtar që duhet të merret vetëm për çështje të riatdhesimit por nuk e di si do të funksionojë në rast se vijnë një numër i madh që riatdhesohen kur kjo zyre ka vetëm një zyrtar.

Xheladin Sadikaj - ligji për formimin e ZKK-ve e detalizon saktë involvimin e një e më shumë akterëve, nëpunësve dhe kërkon mbi 10% të komunitetit.

Kryesuesi - me rregullore thuhet që përbërja e zyrës lokale për çështje të komuniteteve udhëhiqet nga 1 deri në 5 persona minimumi.

Pika 5. Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - në fshatin Gelancë te minoritetet para një muaji është vjedh lopa me dy viqa. Policia kanë qenë.

Avni Bytyqi - në takimin e radhës së KKS-së e ngrit si shqetësim.

Nazim Shabanaj - shqetësimi tjetër është te lodrat e fëmijëve, aty është shumë rrezik.

Xheladin Sadikaj - kontraktuesi e ka pas mirëmbajtjen një vjeqare dhe tash Komuna duhet ta qet përmes tenderit.

Nazim Shabanaj - kanë qenë para dy tre jave. Te rruga, para dy ditëve ka pas ndeshje sepse është rrugë e ngushtë.

Habibe Bytyqi - para një jave kam qenë në vizitë në shkollën e Gelancës dhe është shqetësuese vijueshmëria e shkollimit të komunitetit tuaj. Unë kisha dasht prej dy përfaqësuesve që jeni këtu, të përdorni ndikimin tuaj por realisht nëse keni nevojë me ju ndihmu për ndonjë gjë, me qenë edhe unë apo Komuna.

Nazim Shabanaj - a ke qenë te drejtoresha?

Habibe Bytyqi - po, kam qenë dhe drejtoresha është shumë e shqetësuar. Ata po shkojnë dy ose tre herë deri sa po e marrin një vërtetim se po i kërkon QPS-ja në rast të dhënies së socialit por më tutje nuk po shkojnë. Drejtoresha është e gatshme të bëhet bashkarisht diçka që ata fëmijë që të kthehen në shkollë.

Nazim Shabanaj - sa i përket fshatit Gelancë nuk ka asnjë fëmijë të minoriteteve që nuk shkon në shkollë, e që nuk mësojnë është gjë tjetër.

Habibe Bytyqi - unë e pata për vijueshmëri dhe as një vërejtje tjetër nuk ishte.

Kryesuesi - për sot e kam planifikuar edhe një pikë tjetër e cila ka për qëllim formimin e një ekipi nga ky komitet që përbëhet prej dy pjestarëve të komuniteteve dhe dy pjestar asambleista. Mund të ndodhë që ky ekip të dal në teren një herë në muaj ose një herë në dy muaj në qendrat mësimore sa i përket funksionimit të qendrës, mungesave, vijueshmërisë. Kjo ka të bëjë enkas për nxënës të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Nuk do të thotë që ne do të shkojmë shtëpi më shtëpi por nëse ndodh ndonjë fatkeqësi, p.sh kallet shtëpia ose ndodh ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore, ne e kemi si obligim me dal në teren, ta bëjmë një vizitë dhe atë çështje me procesin në polici ose dikastere tjera. Unë kërkoj që të jepni propozimet.

Për këtë komision u propozuan: **Nazim Shabanaj, Denis Sofra, Zek Berisha, Aziz Bytyqi dhe Doruntina Zenelaj.**

Takimi përfundoi: 09:20